



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 313, datë 19.12.2019

PËR DEKLARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 283, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes Vendore së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 168, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi Raportin e Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ngritur me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019 të këtij Këshilli, lidhur me inspektoren {...},

V E N D O S I:

1. Të deklarojë pasjen e statusin “Magjistrat” për znj. {...}.
2. Znj. {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës pranë Njesisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR